

## Neni 53/1<sup>2</sup>

**Kriteret e mëposhtme do të zbatohen vetëm për studentët të cilët kanë filluar studimet para vitit akademik 2014-2015 dhe do të aplikohen deri në përfundim të studimeve të tyre.**

**Në Fakultetin e Mjekësisë, studenti kalon nga njëri vit akademik në tjetrin si më poshtë vijon:**

- a) Në vitin e tretë kur ka siguruar 60 kredite nga viti i parë dhe i dytë.
- b) Në vitin e katërt studenti kalon kur ka siguruar 120<sup>1</sup> kredite nga viti i parë, dytë dhe i tretë.
- c) Në vitin e pestë studenti kalon kur ka siguruar 180 kredite nga viti i parë, dytë, tretë dhe i katërt.
- d) Në vitin e gjashtë kur ka siguruar 240 kredite nga viti i parë, dytë, tretë, i katërt dhe i pestë.

**Në Fakultetin e Farmacisë dhe Fakultetin e Mjekësisë Dentare studenti kalon nga njëri vit akademik në tjetrin si më poshtë vijon:**

- a) Në vitin e tretë kur ka siguruar 60 kredite nga viti i parë dhe i dytë.
- b) Në vitin e katërt studenti kalon kur ka siguruar 120 kredite nga viti i parë, dytë dhe i tretë.
- c) Në vitin e pestë studenti kalon kur ka siguruar 180<sup>3</sup> kredite nga viti i parë dytë, tretë dhe i katërt.

**Në Fakultetin e Shkencave Mjekësore Teknike dhe atë të Shendetit Publik studenti kalon nga njëri vit akademik në tjetrin si më poshtë vijon:**

- a) Në vitin e tretë studenti kalon kur ka siguruar 90 kredite nga viti i parë dhe i dytë.
- b) Përfundon vitin e tretë kur ka siguruar 180 kredite nga viti i parë, viti i dytë dhe viti i tretë.

## Neni 54

### Rishikimi i notës

Studenti ka të drejtën e rishikimit të notës në çdo vit akademik, për deri në një lëndë nga detyrimet e atij viti.

Për rishikim note, studenti provohet vetëm njëherë dhe vetëm në sezonin e vjeshtës duke mbetur në fuqi nota me të cilën studenti vlerësohet në fund.

Kërkesa për rishikim note i paraqitet dekanatit/drejtorisë para sezonit të vjeshtës.

<sup>2</sup> Ndryshuar me Vendim të Senatit Akademik Nr.35, datë 24.07.2015 të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë.

<sup>3</sup> Ndryshuar me Vendimin e Senatit Akademik Nr.39, date 08.09.2015 të Universitetit të Mjekësisë, Tiraë.